



Agricultural University of Tirana

Bazuar në Rregulloren e Studimeve Universitare të UBT-së dhe  
Rregulloren e Brendshme të FMV-së

## **RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

Miratuar në Mbledhjen e Dekanatit, të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare,  
datë 23. 04. 2019

**MIRATOHET**

**DEKANI**

**Prof. Dr. Erinda LIKA**



Tiranë, 2019

## **HYRJJE**

Rregullorja e Programit të Studimeve në FMV është hartuar mbështetur në **VKM Nr. 41**, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, të Sporteve dhe Rinisë”, në rregulloren dhe statutin e UBT, si dhe në praktikën e deritanishme të studimeve universitare.

Rregullorja e Programit të Studimeve në FMV synon:

- Të krijojë një kuadër bashkëkohor dhe operacional mbi studimet universitare;
- Të përcaktojë rregulla standarde të përgatitjes, organizimit dhe administrimit të studimeve universitare;
- Të krijojë të gjitha hapësirat e nevojshme për një menaxhim aktiv e dinamik në nivel të njësisë bazë (Departamenteve) dhe ndihmëse.

Rregullorja është konceptuar për t’i shërbyer:

- Studentëve të FMV
- Pedagogëve të FMV
- Punonjësve kërkimorë, ndihmës mësimorë dhe punonjësve të tjerë të administratës;

Rregullorja, është përgatitur në një kohë kur kuadri nënligjor është në plotësim e sipër. Në këtë kuptim, ajo duhet konsideruar si një dokument i “gjallë”, aktiv e dinamik, e cila mund të përshtatet dhe të ndryshohet gjatë kohës.

## PËRKUFIZIME

Rregullorja e Programit të Studimeve në FMV i shërben studentëve, pedagogëve, punonjësve kërkimorë, ndihmës mësimorë dhe punonjësve të tjerë. Ajo bazohet në rregulloren e studimeve Universitare dhe Statutin e UBT<sup>së</sup>, si dhe në rregulloret e programeve të studimit në nivel Departamenti.

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “**Diplomë**”, dokumenti zyrtar që i jepet studentit në përfundim të programit të studimit, pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike të lidhura me të;
2. “**Grup-lëndë**”, një strukturë akademike dhe administrative organizimi brenda një departamenti, e cila grupon anëtarë të stafit akademik që mbulojnë lëndë të përafërta brenda një fushe të ngjashme studimi;
3. “**Komponent mësimor**”, veprimtari e strukturuar dhe formale mësimore;
4. “**Laborator**”, veprimtaria formuese akademike, gjatë së cilës studenti përvetëson dhe provon aftësitë e tij për të eksperimentuar, investiguar, observuar dhe provuar teori e metoda të caktuara, të planifikuara brenda një lënde të caktuar, e cila mund të vlerësohet me notë dhe me kredite;
5. “**Lëndë**”, një degë e një fushe shkencore, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë sistematike gjatë një kohe të caktuar;
6. “**Modul**”, një pjesë e programit të lëndës, i cili përmbledh në mënyrë të logjikshme, të vazhduar, të rregullt dhe të organizuar tematika të ngjashme, që ndërtohet mbi një numër të kufizuar objektivash mësimorë – akademikë që pritet të realizohen nga studenti;
7. “**Praktikë**”, një veprimtari formuese akademike, që vlerësohet me vlerësim pozitiv ose edhe me notë kaluese e me kredite, gjatë së cilës studentit i kërkohet të zgjerojë dhe të aplikojë njohuritë e marra në auditor, për të fituar aftësi shtesë brenda një mjedisi praktik profesional ose artistik, në kuadër të një programi të caktuar studimi, duke plotësuar kërkesa dhe standarde të njohura etike, profesionale e ligjore;
8. “**Objektiva formues dhe kompetenca profesionale**”, bashkësia e dijeve, aftësive e kompetencave specifike të fushës, që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit.
9. **ECTS - "European Credit Transfer System"** është përcaktimi i kreditit, sipas sistemit European të Transferimit të Krediteve të formimit në arsimin e lartë;

10. **“Programi i studimit”** është një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore shkencore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën studentit të pajiset me një certifikatë, diplomë ose gradë shkencore prej Institucionit të Arsimit të Lartë që e ofron atë, në varësi të llojit të programit të studimit.
11. **“Sistemi i studimeve me kohë të plotë”** përfshin organizimin e programeve të studimit me ngarkesë akademike normale 60 kredite (ECTS) në një vit akademik.

## **KREU I PARË**

### **PARIME TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Baza ligjore**

Rregullorja e Studimeve Universitare në FMV është hartuar mbështetur në **Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"**, në aktet nënligjore, në rregulloren dhe statutin e UBT, në vendimet e Senatit të UBT-së, si dhe në praktikën e deritanishme të studimeve universitare në FMV.

#### **Neni 2**

#### **Objekti dhe efektet e zbatimit të Rregullores**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave standarde për programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë "Mjekësi Veterinare" dhe për diplomën profesionale dy vjecare "Menaxhim Veterinar" në FMV.

1. Kjo Rregullore është hartuar në përputhje me planin mësimor të programeve të studimit, duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik, të studentëve dhe të legjislacionit në fuqi.
2. Kjo Rregullore i shtrin efektet e saj mbi të gjitha njësitë mësimore–shkencore, studentët, pedagogët, operatorët dhe të gjithë personelin e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare (më tej FMV).
3. Të gjitha njësitë bazë (Departamentet), njësitë ndihmëse (laboratorët, klinikat veterinare, etj) dhe ato mësimore–kërkimore duhet të harmonizojnë rregulloret dhe veprimtarinë e tyre në përputhje me këtë rregullore.

#### **Neni 3**

#### **Rregulla të veçanta**

Dekanati i FMV, mund të nxjerrë rregulla ose akte të veçanta të zbatueshme në mënyrë të përhershme apo të përkohëshme vetëm për një fushë, drejtim, objekt apo njësi të caktuar, për të siguruar zbatimin e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rregulloren e UBT dhe këtë Rregullore, ose kur ka detyrim ligjor të posaçëm, në drejtime, situata apo kushte të një rëndësie të veçantë apo të jashtëzakonshme.

#### **Neni 4**

##### **Vendimet, urdhërat dhe udhëzimet**

Vendimet, urdhërat dhe udhëzimet, respektivisht të organeve dhe autoriteteve drejtuese në FMV shtrijnë efektet e tyre në drejtimit përkatëse kur janë hartuar dhe miratuar brenda kompetencave dhe në formën përkatëse.

#### **Neni 5**

##### **Njoftimet**

- a) Në të gjitha rastet kur është e nevojshme ose lidhet me veprimtarinë e tyre, organet dhe autoritetet drejtuese të FMV dhe njësitë bazë, marrin dijeni për aktet ligjore e nënligjore, apo aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tyre, nga struktura më e lartë që administron fillimisht dokumentacionin.
- b) Dorëzimi apo njoftimi mbi aktet e mësipërme, ju bëhet autoriteteve drejtuese dhe anëtarëve të organeve drejtuese, si dhe personelit administrativ, përkundrejt nënshkrimit drejtpërdrejt apo bashkëlidhur tekstit përkatës, i cili ruhet nga komunikuesi për aq kohë sa ka fuqi vepruese akti dhe më pas arkivohet;
- c) Komunikimi i mësipërm është i vlefshëm edhe nëpërmjet postës elektronike zyrtare. Në këtë mënyrë veprohet edhe për aktet e brendshme të organeve dhe njërive përkatëse.

#### **Neni 6**

##### **Njoftimi individual**

- a) Personeli akademik, joakademik dhe studentët marrin dijeni për Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin, Rregulloren e UBT, për këtë Rregullore dhe aktet e tjera me karakter të përhershëm duke njohur vetë tekstin që u vihet në dispozicion nga struktura akademike dhe administrative përkatëse në kohën e fillimit të marrëdhënieve të punës ose studimit;
- b) Ndryshimi apo shfuqizimi i akteve bëhet me komunikim të përgjithshëm duke e afishuar atë në vende të posaçme, përveç kur është i detyrueshëm njoftimi individual;
- c) Tekstet e akteve me karakter të përhershëm dhe ndryshimet e mëvonshme, konsiderohen të njoftuara nëse publikohen në faqen elektronike të FMV në atë të UBT ose kur ka kaluar më shumë se 2 (dy) javë kalendrike nga miratimi në Dekanatin e FMV, përveç rasteve kur ka detyrim për njoftim të personalizuar;
- d) Rregullorja dhe çdo përcaktim i saj përbën objekt të përgjegjësisë individuale për çdo punonjës (staf akademik, ndihmës akademik dhe administrativ) si edhe çdo student të FMV, në çdo rast pasi ka kaluar 2 (dy) javë kalendrike nga miratimi në Dekanat të ndryshimit apo vendimit.

### **Neni 7**

#### **Interpretimi**

- a) Kur në kuadrin e zbatimit të një akti ka qëndrime të ndryshme për përmbajtjen e tij autoriteti drejtues përkatës bën interpretimin i cili kur kërkohet, jepet me shkrim;
- b) Organet më të larta se interpretuesi me iniciativë ose me kërkesë, miratojnë ose ndryshojnë interpretimin e bërë;
- c) Organi që ka nxjerrë aktin bën interpretimin, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë.

### **Neni 8**

#### **Kundërshtimi i interpretimit**

Kur kundërshtohet interpretimi i lëshuesit të aktit, Dekanati ose Dekani sipas rastit, shqyrton ligjshmërinë e interpretimit të vetë aktit dhe bën interpretimin përfundimtar ose ndryshimin përkatës në akt, kur është brenda kompetencave të tij.

### **Neni 9**

#### **Mangësitë në akte**

Në rastet kur në kuadrin e zbatimit të aktit dalin aspekte të parregulluara, lëshuesi i aktit apo organi që ka në kompetencë, përcakton mënyrën e veprimit nisur nga rregullimi i aspekteve të ngjashme e kur është e pamundur nga parimet e përgjithshme të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Statutit. Në këto raste plotësimi i aktit është detyrë e atij organi.

## **KREU I DYTË**

### **FUSHA E STUDIMIT DHE DIPLOMIMIT**

#### **Neni 10**

Në FMV zhvillohen studime universitare të bazuara në programet mësimore dhe kurrikulat. Studimet e përfunduara në FMV sigurojnë (ofrojnë) diplomën “Mjek Veteriner”, që përfaqëson një kualifikim “**Master Shkencor**” në Mjekësinë Veterinare.

### **ELEMENTET QË PËRBËJNË STRUKTURËN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

#### **Neni 11**

Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga FMV, konsistojnë në:

- a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
- b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;
- ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
- d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
- dh) planin mësimor;
- e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
- ë) programin lëndor (Syllabus-et);
- g) diplomën dhe suplementin.

## **Neni 12**

### **Kreditet sipas ECTS-së**

- a) Krediti i formimit të arsimit të lartë i referohet ECTS-së dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.
- b) Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.
- c) Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në FMV, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.
- d) Programi i integruar e studimeve të ciklit të dytë në “Mjekësi Veterinare” është i organizuar në lëndë dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
- e) Vlerësimi përfundimtar konsiston në një notë të vetme për secilën lëndë. Të gjitha lëndët janë të vlerësuara në kredite (ECTS). Cdo vit akademik i planit të studimit përmban 60 ECTS duke arritur në një total prej 300 ECTS për të gjithë programin e studimit.
- f) Orët për punë të pavarur të studentit zënë gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.
- g) Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe gjatë të gjitha viteve.



- h) Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).
- i) Për vitin e 1, 2 të programit të studimit një kredit përbëhet nga 12 orë aktivitet didaktik frontal dhe 13 orë studim individual, ndërsa për vitin e 3, 4, dhe 5 kjo ndarje shkon në 13 ore frontale dhe 12 orë pune individuale.
- j) Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren e studimeve universitare të UBT-së.

Tregues të matshëm:

Plani i studimit parashikon 15 kredite ECTS të dedikuara për Tezën e Diplomës.

Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit

Emërtimi i Diplomës për programin e studimit, **Master i Shkencave në Mjekësi Veterinare**

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- |                          |                          |                                      |
|--------------------------|--------------------------|--------------------------------------|
| - Leksionet              | 10/12 orë në auditor dhe | 15/13 orë punë e pavarur e studentit |
| - Seminaret              | 10/12 orë në auditor dhe | 15/13 orë punë e pavarur e studentit |
| - Laboratorët            | 15/13 orë në auditor dhe | 10/12 orë punë e pavarur e studentit |
| - Praktikat lëndore      | 15/13 orë në auditor dhe | 10/12 orë punë e pavarur e studentit |
| - Praktikën Profesionale | 15/13 orë në auditor dhe | 10/12 orë punë e pavarur e studentit |
| - Teza e Diplomës        | 10/12 orë në auditor dhe | 15/13 orë punë e pavarur e studentit |

### **Neni 13**

#### **Afati i studimeve**

- a) Afati i studimeve në FMV është 5 vjet. Ai kryhet (realizohet) nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në mësim, kërkim dhe praktikë profesionale; gjatë kësaj periudhe nga studentit duhet të përmbushen të gjitha detyrimet, konform programit mësimor dhe currikulës së studimeve në FMV;
- b) Studentët që përfundojnë studimet në FMV diplomohen kur kanë fituar 300 kredite.

### **Neni 14**

#### **Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit**

- a) Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomave.
- b) Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit nga studentit.
- c) Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studentit dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale.
- d) Metodot e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studentit demonstron përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit.
- e) Provimi është forma kryesore e kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studentit ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde (moduli).
- f) Kolokiumi është forma e kontrollit të përvetësimit të lëndës, e cila përfundon brenda periudhës së mësimit, pa sezon. Kolokiumi mund të përsëritet brenda javës pasardhëse.
- g) Studentit i lind e drejta e hyrjes në provimin e një lënde, kur ai ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në planin mësimor dhe në masën e përcaktuar në këtë rregullore.
- h) Studentit i lind e drejta e hyrjes në provim, kur shlyerja e detyrimeve është e konfirmuar nga pedagogu në Pasqyrën e Rezultateve të Detyrimeve, e cila plotësohet me përfundimin e procesit mësimor, para sezonit të provimeve.

- i) Emrat e studentëve të cilët kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës evidentohen në pasqyrën e rezultateve të detyrimeve dhe provimit.
- j) Pasqyra e rezultateve të detyrimeve dhe provimit plotësohet dhe firmoset nga pedagogu/pedagogët e lëndës dhe Dekani si dhe mban vulën e ZSS.
- k) Vlerësimi gjithëvjetor i studentit bazohet në vlerësimin e aktivizimit të tij/saj në praktikat laboratorike, klinike në masën 20%, dhe në kontrollin e dijeve si niveli i diskutimit në seminare dhe të gjitha detyrimet përkatëse sipas lëndëve (testime ndërmjetëse/detyra kursi) në masën 20%. Ky vlerësim gjithëvjetor i studentit është deri në 40 pikë.
- l) Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar propozohet nga Zv. Dekani për mësimin. Miratohet nga Departamenti dhe komunikohet nga përgjegjësi i Departamentit në fillim të vitit akademik.

### **Neni 15**

#### **Forma kryesore e kontrollit të dijeve**

Kontrolli i dijeve mund të kryhet:

- Me shkrim
- Me gojë
- I kombinuar (me shkrim dhe me gojë).

Departamentet përcaktojnë nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese dhe eliminuese. Mënyra e kontrollit të dijeve përcaktohet në programin e modulit dhe në planin mësimor dhe i komunikohet studentëve në fillim të procesit mësimor.

### **Neni 16**

- a) Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej 10 (dhjetë) nota. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë)
- b) Në format e kontrollit me shkrim përdoret edhe sistemi i vlerësimit me pikë, i cili konvertohet me notë, kufiri minimal i kalueshëm është 45 % (dyzet e pesë përqind) e totalit të pikëve të përgjithshme të provimit.
- c) Vlerësimi përfundimtar i studentit bazohet në vlerësimin gjithëvjetor dhe të atij të provimit. Vlerësimi gjithëvjetor i studentit përfshin aktivizimin në praktika dhe seminare si dhe vlerëson përgatitjen e detyrave apo projekteve të kursit.
- d) Rezultatet e provimit/kolokiumit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni, në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim, pas korigjimit të tyre. Në këtë rast rezultatet e provimit shpallen për çdo grup mësimor.

- e) Me përfundimin e provimit, pasqyra e detyrimeve dhe e rezultateve të provimit, hidhen në sistem dhe dorëzohen në ZKA dhe kjo e fundit në ZSS, maksimumi deri 24-48 orë pas përfundimit të provimit. Marrja dhe dorëzimi i tyre bëhet me firmë.
- f) Në përfundim të provimeve, ZSS harton listat e studentëve që për vitin akademik mbartin lëndë, të studentëve mbetës, përsëritës për herë të parë ose të dytë, mbi bazën e të cilave formulohet Urdhëri i Dekanit.

### **Neni 17**

#### **Objektivat formues dhe kompetencat profesionale.**

- a) Objektivat formues dhe kompetencat profesionale të programit të studimit në “Mjekësi Veterinare” përcaktojnë formimin, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që përfiton studenti deri në përfundim të programit të studimit.
- b) Objektivat formues dhe kompetencat profesionale:
  - i) i atribuohen komponentëve të veçantë mësimorë, si dhe programit të studimit në tërësi;
  - ii) përcaktohen në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve gjatë përshkrimit të kualifikimeve individuale, për sa u përket njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara me përfundimin e studimeve.
  - iii) vlerësohen nëpërmjet procedurave të bazuara në kritere të qarta e transparente.

Studimet në FMV synojnë arsimimin profesional dhe formimin shkencor të studentëve në fushën e Mjekësisë Veterinare, nëpërmjet integritit të mësimit me kërkimin. Diplomimi, si një kualifikim i parë profesional, siguron formimin e specialistëve të aftë për të kontribuar në zgjidhjen e problemeve veterinarë në fushën e shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve, shëndetit publik veterinar dhe mbrojtjes së mjedisit. Programi i studimeve i referohet arritjeve teorike dhe praktike në shkencat e mjekësisë veterinarë bashkëkohore dhe synon njehsimin e diplomës me atë të Fakulteteve të Mjekësisë Veterinarë të vendeve të tjera, veçanërisht të vendeve të BE.

Programi i studimeve në Mjekësi Veterinarë në thelbin e tij ka aftësimin profesional për realizimin e qëllimit bazë të tij që konsiston në formimin e figurës profesionale të Mjekut Veterinar për të ushtruar aktivitet të asistencës shëndetësore të inkuadruar në struktura shëndetësore shtetërore dhe private.

Qëllimet e studimeve në Fakultetin e Mjekësisë Veterinarë janë:

- a) Njohja e patologjive të specieve të kafshëve, përfshirë dhe ato zoonotike dhe aftësia diagnostikuese duke përdorur edhe teknikat bashkëkohore;
- b) Njohja e epidemive, diagnoza, profilaksia, terapia dhe kontrolli i sëmundjeve infektive dhe parazitare në kafshë;
- c) Aftësia për të njohur dhe vlerësuar pastërtinë, higjienën, cilësinë dhe alteracionet e mundshme të ushqimeve me origjinë shtazore;
- d) Njohja e normave të legjislacionit sanitar të produkteve me origjinë shtazore;
- e) Njohja e të ushqyerit dhe të teknologjive të mbarështrimit të kafshëve dhe përmirësimit gjenetik të tyre;
- f) Aftësia për të konstatuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike impaktin e mbarështrimit të kafshëve mbi mjedisin;
- g) Njohja e lidhjeve njeri – kafshë dhe kafshë - mjedis, bioteknologjive gjenetike dhe riprodhimit, biologjisë molekulare dhe përdorimet e tyre;
- h) Njohuri mbi karakteristikat e menaxhimit, marketingut dhe drejtimit të fermave të kafshëve;
- i) Njohja e normativave kombëtare dhe atyre të Komunitetit Europian përsa i përket kompetencave veterinarë;
- j) Njohja e nocioneve informatike dhe raportet themelore për hyrjen në tregun e punës dhe drejtimin profesional.

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ofron program studimi Master i Shkencave (Msc) me objektiv formimin e specialistëve veterinar në fushën përkatëse. Programi ka karakter të theksuar mjekësor dhe synon të pajisë studentët me aftësitë e duhura, duke ju dhënë atyre njohuritë bazë dhe të aplikuara në profesionin përkatëse. Ky program synon të aftësojë studentët për t'u përfshirë në aktivitete konkrete dhe për tu angazhuar në funksione të ndryshme në sektorin publik apo privat. Të diplomuarit në specialitetet e ofruara nga ky fakultet përgatiten të bëhen profesionistë në fushat përkatëse për të marrë pjesë në aktivitete direkte të parandalimit, kurimit dhe të ruajtjes së shëndetit të kafshëve dhe publik. Programi i studimit në "Mjekësi Veterinare" është licensuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr 560, dt.12.08.2005. Ky program është i organizuar në mënyrë të tillë që të diplomuarit:

- a) Të zotërojnë njohuri të përshtatshme në disiplina bazë, çka bën të mundur kuptimin e elementëve kryesorë të proceseve patologjike në të cilat fokusohet ndërhyrja parandaluese ose/dhe terapeutike;

- b) Të jenë profesionistë të aftë të marrin pjesë në procesin diagnostik duke njohur manifestimet klinike të hasura gjatë dekursit të sëmundjeve dhe trajtimin e tyre;
- c) Të jenë të aftë të marrin pjesë në procesin e informimit, edukimit dhe mbështetjes së kafshës gjatë ndërhyrjeve diagnostiko - terapeutike e mediko – kirurgjikale;
- d) Të pajisen me njohuritë e duhura në lidhje me formimin e bazës kulturore për procesin e aplikimit të profesionit në dimensione tekniko – shkencore dhe ligjore veterinarë që rregullojnë aktivitetin e lirë profesional dhe përgjegjësitë profesionale;
- e) Të pajisen me informacionin e duhur në lidhje me principet që orientojnë procesin diagnostik, kultural dhe teknik gjatë jetës profesionale.

Shpërndarja e disiplinave në vite studimi është realizuar në mënyrë kronologjike, duke filluar me formimin bazë, e deri në konkretizimin profesional dhe praktik në programet specifike.

## **Neni 18**

### **Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit**

- a) Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:
  - i) mësim në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;
  - ii) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
  - iii) përgatitje për provime;
  - iv) përgatitje e tezës së diplomës;
  - v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.
- b) Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë.
- c) Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u përlllogaritet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

## Neni 19

### Elementët e mësimi

Elementet kryesorë të mësimi në FMV janë: Leksionet (ligjeratat), punët laboratorike, praktikat klinike, seminarët, ushtrimet, detyrat me shkrim, detyrat e kursit, projektet e kursit, ekskursionet mësimore, kolokiumet, provimet e kursit, praktika profesionale dhe mbrojtja e saj, si dhe provimi i temës së diplomës.

## Neni 20

### Frekuentimi

- a) **Frekuentimi i leksioneve, i Praktikave laboratorike dhe ato klinike** janë të detyrueshme në masën 80%, pa shlyerje në fund të vitit. Ato i shërbejnë studentit për konkretizimin dhe thellimin e njohurive, për përvetësimin e metodave laboratorike e klinike, si dhe për aftësimin praktik. Nëse studenti nuk ka frekuentuar mbi 20 % të tyre, humbet të drejtën e provimit në atë lëndë, deri sa të kryejë shlyerjet e nevojshme në vitin pasardhës, në seancat respektive.
- b) **Detyrimet në lëndët** që mbulohen nga Departamente të tjera jashtë FMV-së, i nënshtrohen Rregullores së UBT.
- c) Afatet dhe mënyra e shlyerjes përcaktohen nga Departamenti. Vlerësimi i tyre është pjesë e vlerësimit gjithvjetor të studentit.
- d) **Detyrat dhe/ose Projektet e kursit miratohen në fillim të vitit akademik në Departament.** Numri, afatet dhe mënyra e shlyerjes përcaktohen nga departamenti. Vlerësimi i tyre është pjesë e vlerësimit gjithëvjetor të studentit.
- e) Mospjesëmarrja e studentëve në zhvillimin e elementëve të mësimi me frekuentim të detyrueshëm, vlerësohet me mungesa në regjistrin zyrtar dhe evidentohet.
- f) Rregjistri është dokument shtetëror bazë për të evidentuar zhvillimin e mësimi dhe mungesave. Çdo pedagog është i detyruar të shënojë në rregjister emërtimin e lëndës dhe elementet e mësimi të zhvilluar, si dhe të pasqyrojë saktë mungesat.
- g) Departamentet gjejnë modalitetet dhe mbajnë evidencat e lëndëve të tyre.

## Neni 21

### Praktika Profesionale

- a) **Praktika Profesionale** është pjesë përbërëse e studimeve universitare në FMV. Ajo shërben për të konsoliduar njohuritë teorike dhe për të fituar shprehitë praktike me synim ushtrimin më pas gjatë aktivitetit si mjek veteriner. Ajo pasqyrohet në planet mësimore dhe me fillimin e vitit akademik, Zv/Dekani mësimor u komunikon studentëve njohuritë per kohën, vendin e

kryerjes dhe programin përkatës. Praktika profesionale përfshin 14 javë, pas semestrit të IX dhe kryhet në subjekte të përshtatshme, me nivel të njohur kualifikimi për trajnimin praktik veterinar, si klinikat veterinare, laboratorët diagnostikë dhe institucionet kërkimore (ISUV), stabilimentet blegtorale të kafshëve dhe përpunimit të prodhimeve ushqimore me origjinë shtazore për konsum human, në sektorët veterinarë të Qarkut, zyrat veterinare vendore, etj.

- b) Praktika profesionale mund të kryhet edhe jashtë vendit (shtetit). Në të gjithë rastet, studenti paraqet një raport teknik mbi aktivitetin e kryer gjatë praktikës, të firmosur nga personi përgjegjës i subjektit ku e ka kryer, si dhe dëshminë përkatëse që vërteton se studenti e ka realizuar praktikën sipas programit.
- c) Studenti detyrohet të respektojë rregullat dhe disiplinën e institucionit apo qendrës ku kryhet praktika profesionale.
- d) Pranë FMV organizohet dhe funksionon Komisioni i Praktikës Profesionale të studentëve, i cili propozohet nga Departamentet që kanë disiplinë në programin e kësaj praktike dhe miratohet nga Dekani.
- e) Për drejtimin dhe administrimin e praktikave caktohet **një koordinator**, i cili miratohet nga Dekani.
- f) Praktika Profesionale sipas programit, udhëhiqet e drejtohet nga pedagogët përkatës të fakultetit, në bashkëpunim me specialistët e subjekteve apo institucioneve ku ajo kryhet.
- g) Praktika Profesionale është e detyrueshme për të gjithë studentët, bazuar në programin e hartuar nga Departamentet e të miratuar nga Dekanati i FMV.
- h) Në përfundim të praktikës profesionale, studenti realizon mbrojtjen para një komisioni, duke paraqitur dokumentacionin përkatës (ditari, raporti, dëshmia dhe vlerësimi nga çdo subjekt ku është zhvilluar praktika).
- i) Mbrojtja e praktikës vlerësohet me notë. Komisioni i vlerësimit të praktikës profesionale propozohet nga Dekanati dhe miratohet nga Dekani. Kryetari i Komisionit, si rregull, caktohet një pedagog i lëndëve klinike.
- j) Studenti që nuk realizon programin e praktikës profesionale, i nënshtrohet rregullave të përcaktuara nga kjo rregullore, si për të gjitha detyrimet e tjera.
- k) Studenti që nuk realizon mbi 10% të orëve të praktikës profesionale, pavarësisht nga arsyet, i shlyen ato në periudhën e verës, duke shtyrë marrjen e diplomës për 6 muaj. Po kështu, i shtyhet 6 muaj marrja e diplomës edhe studentit që vlerësohet negativisht në provimin për



mbrojtjen e praktikës profesionale. Pas 6 muajsh, ai i nënshtrohet përsëri mbrojtjes së praktikës profesionale para se të mbrojë diplomën.

## Neni 22

### Kategoritë e veprimtarive formuese dhe Plani mësimor

- a) Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS.
- b) Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:
  - i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
  - ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
  - iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;
  - iv) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;
  - v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.
- c) Veprimtaritë formuese janë:
  - i) të detyrueshme;
  - ii) të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga FMV, dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit.
- a) Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – E;
- b) Në planin mësimor të **Programit të studimeve të Integruara “Master i shkencave” në “Mjekësi Veterinare”** janë përcaktuar: i) lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra; ii) kreditet përkatëse.

Veprimtaritë formuese në programin e studimeve të integruara në “Mjekësi Veterinare” përcaktohen në tabelën e mëposhtme:

**Programi i studimeve të Integruara Master i shkencave në “Mjekësi Veterinare”**

Nr.	Emërtimi i Lëndëve	Kategoria	Tipi i Komponentit mësimor	Raporti Orëve		Orë Gjiths.	Nr. Kred. ECTS
				Leks.	Sem.		
1	Termin. Mjekësore	D	Lëndë Plotësuese	0	30	30	3
2	Biometri	A	Lëndë Bazë	15	15	30	3
3	Menaxhimi i Fermave	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	15	15	30	3
4	Kimi inorganike	A	Lëndë Bazë	30	15	45	3
5	Anatomi e kafshëve (I)	A	Lëndë Bazë	45	75	120	10
6	Gjuhë e huaj	D	Lëndë Plotësuese	-	60	60	4
7	Histologji-Embriol.	A	Lëndë Bazë	60	60	120	10
8	Biologji & Biol. Mol	A	Lëndë Bazë	60	45	105	9
9	Botanikë	A	Lëndë Bazë	15	15	30	3
10	Lende me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	15	-	15	1
11	Informatike	D	Lëndë Plotësuese	15	15	30	3
12	Biofizikë	A	Lëndë Bazë	30	30	60	5
13	Kimi organike	A	Lëndë Bazë	30	15	45	3
14	Higjienë	B	Lëndë Karakterizuese	45	15	60	5
15	Anatomi e kafshëve (II)	A	Lëndë Bazë	45	30	75	7
16	Fiziologji	B	Lëndë Karakterizuese	60	45	105	9
17	Biokimi	B	Lëndë Karakterizuese	60	45	105	9
18	Mikrobiologji Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	60	30	90	8
19	Virologji & Imunologji	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	60	30	90	8
20	Gjenetike	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	30	15	45	3
21	Zootekni	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	30	15	45	4
22	Të ushqyer	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	30	15	45	4
23	Mirëqënie e kafshëve	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	30	-	30	2

Rregullorja e Programit të Studimeve në FMV

24	Lëndë me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	15	-	15	1
25	Sëm. Kafsheve te egra	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	4
26	Patologji Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	90	60	150	12
27	Farmak. & Farmak. klinik	B	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	60	30	90	8
28	Parazitologji	B	Lëndë Karakterizuese	45	30	75	7
29	Diagnozë Laboratorike	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	5
30	Propedeutike Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	30	90	120	9
31	Sëmundje infektive&epidem.	B	Lëndë Karakterizuese	60	45	105	9
32	Radiologji-Ekografi	B	Lëndë Karakterizuese	30	15	45	4
33	Lëndë me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	15	-	15	2
34	Iktiopatologji	B	Lëndë Karakterizuese	45	30	75	6
35	Riprodhim i kafsheve	B	Lëndë Karakterizuese	60	60	120	9
36	Kirurgji Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	90	60	150	12
37	Semundje Ripërtypës	B	Lëndë Karakterizuese	60	60	120	9
38	Sëmundje Kafshë shoq.	B	Lëndë Karakterizuese	60	60	120	9
39	Sëmundjenjêthundrakë	B	Lëndë Karakterizuese	60	45	105	8
40	Higjienë qumësht, vezë	B	Lëndë Karakterizuese	45	30	75	6
41	Lëndë me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	15	-	15	1
42	Higjienë mish, thertore	B	Lëndë Karakterizuese	45	30	75	6
43	Toksikologji Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	5
44	Legjislacion Veterinar	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	30	15	45	3
45	Sëmundje Derrash	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	5
46	Sëmundje shpendësh	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	5
47	Mjek. Ligjore&Nekropsi	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	30	15	45	4
48	MenaxhimKariere	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	15	-	15	1
49	Lëndë me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisciplinore/integruese	15	-	15	1
50	Praktike Profesionale	D	Lëndë Plotësuese	-	375	375	15
	Diplomimi	E	Detyrime Përmbyllëse				15
				<b>1845</b>	<b>1830</b>	<b>3675</b>	<b>300</b>

(Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018)

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Master i shkencave (i integruar)
<b>A</b>	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15% - 20% (45-60 kredite)
<b>B</b>	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	45% - 55% (135-165 kredite)
<b>C</b>	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12% -15% (36-45 kredite)
<b>D</b>	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	6 – 8 % (18- 24 kredite)
<b>E</b>	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%-5% (9-15 kredite)

### LËNDË BAZË A

(Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme ose Lëndë të formimit të përgjithshëm)

Nr.	Emërtimi i Lëndëve	Kategoria	Tipi i Komponentit mësimor	Raporti Orëve		Orë Gjiths.	Nr. Kred. ECTS
				Leks.	Sem.		
1	Biometri	A	Lëndë Bazë	15	15	30	3
2	Kimi inorganike	A	Lëndë Bazë	30	15	45	3
3	Anatomi e kafshëve (I)	A	Lëndë Bazë	45	75	120	10
4	Histologji-Embriol.	A	Lëndë Bazë	60	60	120	10
5	Biologji & Biol. Mol	A	Lëndë Bazë	60	45	105	9
6	Botanikë	A	Lëndë Bazë	15	15	30	3
7	Biofizikë	A	Lëndë Bazë	30	30	60	5
8	Kimi organike	A	Lëndë Bazë	30	15	45	3
9	Anatomi e kafshëve (II)	A	Lëndë Bazë	45	30	75	7
				<b>330</b>	<b>300</b>	<b>630</b>	<b>53</b>

### LËNDË KARAKTERIZUESE B

(Përgatitje për disiplinën shkencore ose Lëndë formuese specifike)

Nr.	Emërtimi i Lëndëve	Kategoria	Tipi i Komponentit mësimor	Raporti Orëve		Orë Gjiths.	Nr. Kred. ECTS
				Leks.	Sem.		
1	Fiziologji	B	Lëndë Karakterizuese	60	45	105	9

2	Biokimi	B	Lëndë Karakterizuese	60	45	105	9
3	Mikrobiologji Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	60	30	90	8
4	Sëm. Kafsheve te egra	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	4
5	Patologji Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	90	60	150	12
6	Higjienë	B	Lëndë Karakterizuese	45	15	60	5
7	Parazitologji	B	Lëndë Karakterizuese	45	30	75	7
8	Diagnozë Laboratorike	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	5
9	Propedeutike Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	30	90	120	9
10	Sëmundje infektive&epidem.	B	Lëndë Karakterizuese	60	45	105	9
11	Radiologji-Ekografi	B	Lëndë Karakterizuese	30	15	45	4
12	Iktiopatologji	B	Lëndë Karakterizuese	45	30	75	6
13	Riprodhim i kafsheve	B	Lëndë Karakterizuese	60	60	120	9
14	Kirurgji Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	90	60	150	12
15	Semundje Ripërtypës	B	Lëndë Karakterizuese	60	60	120	9
16	Sëmundje Kafshë shoq.	B	Lëndë Karakterizuese	60	60	120	9
17	Sëmundjenjëthundrakë	B	Lëndë Karakterizuese	60	45	105	8
18	Higjienë qumësht, vezë	B	Lëndë Karakterizuese	45	30	75	6
19	Higjienë mish, thertore	B	Lëndë Karakterizuese	45	30	75	6
20	Toksikologji Veterinare	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	5
21	Sëmundje Derrash	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	5
22	Sëmundje shpendësh	B	Lëndë Karakterizuese	30	30	60	5
				<b>1095</b>	<b>900</b>	<b>1995</b>	<b>161</b>

**LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE C**  
(Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje)

Nr.	Emërtimi i Lëndëve	Kategoria	Tipi i Komponentit mësimor	Raporti Orëve		Orë Gjiths.	Nr. Kred. ECTS
				Leks.	Sem.		
1	Menaxhimi i Fermave	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	15	15	30	3
2	Lëndë me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	15	-	15	1
3	Farmak. & Farmak. klinik	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	60	30	90	8
4	Virologji & Imunologji	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	60	30	90	8
5	Gjenetike	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	30	15	45	3
6	Zootekni	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	30	15	45	4
7	Të ushqyer	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	30	15	45	4
8	Mirëqenie e kafshëve	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	30	-	30	2
9	Lëndë me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	15	-	15	1

10	Lëndë me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	15	-	15	2
11	Lëndë me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	15	-	15	1
12	Legjislacion Veterinar	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	30	15	45	3
13	Mjek. Ligjore&Nekropsi	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	30	15	45	4
14	MenaxhimKariere	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	15	-	15	1
15	Lende me zgjedhje	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	15	-	15	1
				<b>405</b>	<b>150</b>	<b>555</b>	<b>46</b>

### LËNDË PLOTËSUESE D

(Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale)

Nr.	Emërtimi i Lëndëve	Kategoria	Tipi i Komponentit mësimor	Raporti Orëve		Orë Gjiths.	Nr. Kred. ECTS
				Leks.	Sem.		
1	Termin. Mjekësore	D	Lëndë Plotësuese	-	30	30	3
2	Gjuhë e huaj	D	Lëndë Plotësuese	-	60	60	4
3	Informatike	D	Lëndë Plotësuese	15	15	30	3
4	Praktike Profesionale	D	Lëndë Plotësuese	-	375	375	15
				<b>15</b>	<b>480</b>	<b>495</b>	<b>25</b>

### DETYRIME PËRMBYLLËSE E

Nr.	Emërtimi i Lëndëve	Kategoria	Tipi i Komponentit mësimor	Raporti Orëve		Orë Gjiths.	Nr. Kred. ECTS
				Leks.	Sem.		
1	Diplomimi	E	Detyrime Përmbyllëse				15

### Neni 23

#### Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore në FMV

Mësimi zhvillohet në bazë grupi e kursi. Leksionet zhvillohen në bazë kursi, praktikat mësimore laboratorike të lëndëve profesionale dhe praktikat klinike zhvillohen me grupe me jo më pak se 25 studentë. Për raste të veçanta ndryshime që lidhen sidomos me zvogëlimin e grupeve mund të bëhen vetëm me miratimin e Rektorit të UBT.

### Neni 24

#### Programi lëndor (syllabus-et).

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

- a) Emërtimi i lëndës
- b) Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- c) Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- d) Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- e) Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- f) Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- g) Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- h) Ngarkesa në orë në auditor si dhe në ECTS
- i) Format e vlerësimit të studentëve
- j) Detyrimet e studentit për lëndën
- k) Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Modeli i programit të lëndës, që do të përdoret për hartimin e syllabus-eve në këtë program, duhet të përmbajë elementet sipas përcaktimeve të paraqitura.

### **PROGRAMI I LËNDËS**

*(Emri i lëndës)*

*Shënim. Të gjitha shënimet brenda kllapave, duhet të fshihen, përfshirë këtë shënim)*

**Titullari/pedagogu i lëndës:** *(emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshkrimi)*

**Ngarkesa:** *(numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)*

**Tipologjia e lëndës:** *( psh: B, lëndë karakterizuese)*

**Viti Akademik/Semestri kur zhvillohet:** *(Viti i dytë, semestri i parë)*

**Lloji i lëndës:** *(numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)*

**Programi i studimit:** *(Për studentët e )*

**Kodi i lëndës:**

**Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës:**

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT**

*(Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës)*

**KONCEPTET THEMELORE** ( janë koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda)

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....

**TEMAT E LËNDËS**

<b>Tema I</b>	
<b>Tema II</b>	
<b>Tema III</b>	
<b>Tema IV</b>	
<b>Tema V</b>	
<b>Tema VI</b>	
<b>Tema VII</b>	
<b>Tema VIII</b>	
<b>Tema IX</b>	



<b>Tema X</b>	
<b>Tema XI</b>	
<b>Tema XII</b>	
<b>Tema XIII</b>	
<b>Tema XIV</b>	
<b>Tema XV</b>	-

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE** (renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar etj.)

**FREKUENTIMI:** 80%

**KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

- |   |      |
|---|------|
| • Angazhim në seminare/laboratore, pune praktike      | 20 % |
| • Detyra kontrolli (testime ndërmjetëse/detyra kursi) | 20%  |
| • Provim përfund. (me gojë)                           | 60 % |
| • TOTALI  | 100% |

**LITERATURA**

- a. Literatura bazë e detyrueshme:
- b. Literatura e rekomanduar:

**VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS:**

## Neni 25

### Kushtet e kalimit në vitin pasardhës

- a) Për studentët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, studentët e kursit të parë fitojnë të drejtën e regjistrimit në kursin e dytë, nëse minimalisht kanë grumbulluar **25** kredite.
- b) Për studentët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, studentët e kursit të dytë fitojnë të drejtën e regjistrimit në kursin e tretë, nëse minimalisht kanë grumbulluar **80** kredite.
- c) Studentët e kursit të tretë të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare fitojnë të drejtën për të kaluar në vitin e katërt nëse minimalisht kanë grumbulluar **135** kredite.
- d) Studentët e kursit të katërt të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare fitojnë të drejtën për të kaluar në kursin e pestë, nëse, minimalisht, kanë grumbulluar **195** kredite.

## Neni 26

### Testi internacional i gjuhës së huaj

- a) Në përfundim të kursit të plotë të studimeve universitare, studenti ka të drejtë të diplomohet. Studenti i regjistruar në programin “Master i Shkencave” ka të drejtë të paraqitet në provimin e formimit apo në mbrojtjen e tezës së diplomës **vetëm pasi ka kaluar me sukses testin internacional të gjuhës së huaj.**
- b) Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 76 dhe në aktet nënligjore, për programin e integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave” kriteri diplomimi është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj është i përcaktuar me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

## Neni 27

### Modalitetet e diplomimit

- a) Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit;
- b) Studenti, para mbrojtjes së punimit të diplomës duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin, bibliotekën shkencore, bibliotekën kombëtare, konviktet, etj;

## **Neni 28**

### **Diploma dhe suplementi**

- a. Studentet që kanë plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe kanë mbrojtur diplomën (temë diplomë ose provim formimi), pajisen me **diplomën përkatëse**, e cila i dorëzohet studentit së bashku me **Listën e notave**.
- b. Diploma plotësohet me shkrim, qartë dhe me bojë teknike. Ajo nënshkruhet nga Dekani i FMV dhe Rektori i Universitetit. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri dhe niveli i arsimimit të përfutur (p.sh. Master i Shkencave në Mjekësi Veterinare). Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet gjithmonë me vulën e Universitetit.
- c. Dorëzimi i diplomës në FMV organizohet në muajin Nëntor, pas përfundimit të provimit të formimit. Në ceremoninë e dorëzimit të diplomave marrin pjesë studentë dhe të afërm të tyre, drejtues të Fakultetit, Universitetit si dhe të ftuar nga MASR.
- d. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet Çertifikatë “Medalje e Artë”.
- e. Për studentët, të cilët gjatë studimeve kanë marrë mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesa tjetër vetëm 9 (nënta), i jepet Çertifikata “Student i Shkëlqyer”.
- f. Në të gjithë rastet e mësipërme cilësimi bëhet edhe në diplomë.
- g. Diplomat, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të cikli të dytë, shoqërohen me suplementin e diplomës.
- h. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe përshkruan natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.

## **Neni 29**

### **Mobilitetet e Studentëve në kuadër të Programeve të Shkëmbimit**

- a) Studentët që lëvizin në kuadrin e Programeve dhe Projekteve kualifikuese ku Universiteti është palë, kanë status të veçantë dhe lirohen nga detyrimet e kësaj rregulloreje, lidhur me frekuentimin.
- b) Në këto raste, studenteve u njihen provimet e dhëna jashtë shtetit, për lëndët e ngjashme, kur programet barazvlerësohen. Kur kthehen në Fakultet, ata duhet të shlyejnë detyrimet për lëndët e tjera, të cilat nuk duhet të kalojnë masën 50% të detyrimeve vjetore të planit mësimor ekzistues.

- c) Shlyerja e detyrimeve mësimore bëhet me plan individual, të hartuar nga Departamenti përkatës dhe të miratuar nga Dekani, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 30**

Kjo rregullore e shtrin veprimtarinë duke filluar nga viti akademik 2018-2019 dhe në vazhdim.

**Neni 31**

Të drejtën e patjetërsueshme të interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Rektori i UBT.

**D E K A N I**

**Prof. Asoc. Erinda LIKA**